

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 443, datë 6.10.2022

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË AUTORIZIMIT PËR PESHKIMIN
ÇLODHËS-ARGËTUES DHE TARIFAVE PËR SHËRBIMET QË OFROHEN NGA
ORGANIZATAT E PESHKIMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 43, dhe të pikës 6, të nenit 65, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

URDHËROJNË:

1. Tarifat e autorizimit të peshkimit çlodhës-argëtues përcaktohen sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Tarifat për shërbimet që organizata e peshkimit ofron për një mjet lundrues dhe për personat që hyjnë dhe shfrytëzojnë portin ose qendrën e peshkimit përcaktohen sipas tabelave nr. 2 dhe nr. 3, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e autorizimit të peshkimit çlodhës-argëtues do të derdhen në buxhetin e shtetit apo në njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me autoritetin përgjegjës që lëshon autorizimin për peshkim.

4. Të ardhurat e gjeneruara nga tarifatat që organizata e peshkimit ofron për shërbimet për mjetet lundruese për anëtarët dhe personat që nuk janë anëtarë të organizatës do të përdoren në funksion të organizatës së peshkimit për investime në infrastrukturën e transferuar dhe/ose për rritjen e shërbimeve të ofruara ndaj anëtarëve, sipas qëllimit për të cilin kjo infrastrukturë është transferuar pasi të ketë marrë më parë miratim nga ministri përgjegjës për peshkimin.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe organizatat e peshkimit, ndërsa për tarifatat e peshkimit amator ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

MINISTËR I FINANCEVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

Tabela Nr. 1*Tarifat e autorizimit të peshkimit çlodhës-argëtues*

Nr.	Emërtimi	Vlera në Lekë
1.	Peshkimi amator në ujëra të brendshme	1 000 lekë/vit
2.	Peshkimi amator bregdetar	1 000 lekë/vit
3.	Peshkimi turistik për mjetet e lundrimit shqiptare dhe të huaja	1 000 lekë/ditë
4.	Peshkimi turistik për mjetet lundruese të peshkimit	-
5.	Peshkimi sportiv pa mjete lundruese	-

Tabela Nr. 2*Tarifat që organizata e peshkimit ofron për shërbimet për mjetet lundruese dhe për anëtarët e organizatës*

Nr.	Emërtimi	Vlera në Lekë
1.	Dhoma frigoriferike	15 000 lekë/muaj
2.	Ambiente për zyra	2 000 lekë/m ² /muaj
3.	Tarifë shërbimi për mjetet e peshkimit nën 20 metra	3 000 lekë/muaj
4.	Tarifë shërbimi për mjetet e peshkimit 20-25 metra	5 000 lekë/muaj
5.	Tarifë shërbimi për mjetet e peshkimit mbi 25 metra	8 000 lekë/muaj
6.	Bokset për materiale	5 000 lekë/muaj

Tabela Nr. 3*Tarifat që organizata e peshkimit ofron për shërbimet për mjetet lundruese dhe personat që nuk janë anëtarë të organizatës*

Nr.	Emërtimi	Vlera në Lekë
1.	Dhoma frigoriferike	30 000 lekë/muaj
2.	Ambiente për zyra	4 000 lekë/m ² /muaj
3.	Tarifë shërbimi për mjetet e peshkimit nën 20 metra	6 000 lekë/muaj
4.	Tarifë shërbimi për mjetet e peshkimit 20-25 metra	10 000 lekë/muaj
5.	Tarifë shërbimi për mjetet e peshkimit mbi 25 metra	16 000 lekë/muaj
6.	Bokset për materiale	10 000 lekë/muaj